

UDHËZUES PËR FERMERËT

Merrni mbrapsht 10% nga shitjet tuaja bujqësore

10%
kthim mbrapsht

Si fermer i regjistruar mund të aplikoni vetë, online në eFiling, për kompensimin 10%. Ja gjithçka në një faqe.

Ju mund të aplikoni nëse :

- Jeni fermer i regjistruar**
I regjistruar si prodhues bujqësor pranë administrates tatimore .
- Nuk jeni i regjistruar për TVSH**
Skema vlen vetëm jashtë regjimit të TVSH-së.
- Statusi juaj është "aktiv"**
Ju ushtroni aktivitetet .


Çfarë të keni gati

- Kredencialet e eFiling**
NIPT-i dhe fjalëkalimi juaj.
- Llogaria bankare**
Të dhënat të regjistruara ne e-filing / detajet e bankës .
- Faturat e shitjeve**
Sistemi i sjell vetë nga periudha sipas kritereve përkatëse .

5 hapat e aplikimit në eFiling


- Hyni në eFiling**
Identifikohuni në llogarinë tuaj në eFiling me NIPT-in dhe fjalëkalimin, pastaj shkoni te menuja "Çështjet e mia"
 Sigurohuni fillimisht të keni plotësuar të dhenat e llogarisë tuaj bankare ne menune Detajet e Bankes . Pas hyrjes gjeni hapësirën tek çështjet e mia .

- Krijoni kërkesën**
Shtypni "Krijoni një Çështje të Re" dhe zgjidhni llojin "Kërkesë për rimbursim të fermerëve".



- Hapet formulari me të dhënat tuaja dhe periudhën 6-mujore.

- Plotësoni formularin**
Zgjidhni faturat që doni të përfshini dhe zgjidhni llogarinë bankare ku doni të merrni paratë (e detyrueshme).




- Sistemi llogarit vetë Shumën Totale dhe Kompensimin 10%.

- Përfundoni Aplikimin**
Përfundoni aplikimin duke klikuar tek "Dorëzo Kërkesën"



- Sistemi kontrollon afatin, faturat dhe llogarinë para se ta pranojë.

- Ndiqni statusin**
Kërkesa juaj merr statusin " Në proces ". Përgjigjen e gjeni te menuja " Të dorëzuara ". Me kërkesë të Administratës Tatimore ju mund të bashkëngjisi dokumenta shtesë sipas informacionit të kërkuar.



- Sa kohë keni një kërkesë në proces, nuk mund të krijoni një tjetër.

Çfarë ndodh pasi dorëzoni

- Kërkesa kalon në Drejtorinë Rajonale Tatimore**
Ku jeni i regjistruar
- Kryhet verifikimi i të dhënave**
Sipas kritereve ligjore të skemës.
- Kryhet trajtimi procedural i çështjes**
Sipas procedurës së përcaktuar
- Merrni përgjigjen**
Aprovuar ose Refuzuar — te "Të dorëzuara".

⚠ Pse mund të bllokohet aplikimi

Shmangni këto gabime të zakonshme:

- Jeni i regjistruar për TVSH.
- Statusi juaj nuk është "aktiv".
- Aplikoni pas afatit të përcaktuar të periudhës.
- Nuk përzgjidhni faturat
- Nuk zgjidhni llogarinë bankare.
- Keni tashmë një kërkesë "Në proces".

📄 Për ndihmë, drejtohuni në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve ku jeni i regjistruar.